

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr.56/2018	Data: 30.05.2018	

Kuvendi i Komunës, në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2 pika (d) dhe nenit 14, paragrafi 1, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008) në lidhje me nenin 11, paragrafi 4, të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr. 04/L-144 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës me Nr. 35/2012) dhe nenit 21 të Rregullores 23/2013 për përcaktimin e procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimit të Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 83 të Statutit të Komunës së Istogut 01 Nr.62/2010, në mbledhjen e mbajtur me 30.05.2018, miratoi këtë:

P L O T Ë S I M - V E N D I M
I KUVENDIT KOMUNAL NË ISTOG, 01 NR.69/2017, E DATËS
05.05.2017

1. Në pikën dy të këtij Vendimi të Kuvendit Komunal në Istog, 01 Nr.69/2017, e datës 05.05.2017, pas fjalës do të këmbehet më pronën publike plotësohet me këtë:
2. Me pjesë të Njesisë Kadastrale, Nr. 00082-1, me sipërfaqe prej 2484 m², Nr. 00082-2 me sipërfaqe prej 983 m², Nr. 00082-3, me sipërfaqe prej 493 m², Zona Kadastrale, Gurrakoc, e evidentuar si pronë shoqërore, KK. Istog, në certifikatat pronësore me numër të Referencës, 3488/2018 e lëshuar më 15.05.2018 që i përgjigjet vlerës së tregut me pronën e këmbyer.
3. Pas miratimit të këtij vendimi vlerësimin e pronës që është objekt i këmbimit do ta bëjë Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme, Departamentit të Tatimit në pronë, Ministria e Financave.
4. Ky Vendim hynë në fuqi shtatë ditë pas publikimit të tij në ueb faqen e komunës. Për realizimin e tij kujdesen, Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, të Komunës së Istogut.

Më kopje të këtij vendimi të njoftohen Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe një kopje në arkivin e Kuvendit



 REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT
 REPUBLIKA KOSOVO OPŠTINA ISTOK
 DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
 UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE
 Uales-Izlazna
 Nr: 01-05-39 Data 04.06.2018
 Br: _____ Datum _____
 ISTOG-ISTOK

KRYESUESI I KUVENDIT

z. Qaush Balaj

